



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 23 Maj 2022

Nr: 16

**VENDIM**

**PËR**

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 09, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 19.05.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2022, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli Bele	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Kryetari i Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 152, datë 28.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



## VËREN:

Kryetari i Bashkisë Durrës, Zj Emiriana Sako ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 09 regj., datë 19.05.2022.

Në mbledhjen e datës 23.05.2022, ora 12:00, pas relativitetit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 09 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 09, datë 19.05.2022, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Durrës, Zj Emiriana Sako.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 27 Maj 2022, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>Bele</b>	-	<b>Anëtar</b>